

VENDIM
Nr.4, datë 7.8.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, më datën 7.8.1992, shqyrtoi në seancë gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr.4 që i përket:

KËRKUES: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, i përfaqësuar nga Namik Dokle dhe Bashkim Caka.

SUBJEKTE TË INTERESUARA

1. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i përfaqësuar nga Petrika Minga.
2. Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, i përfaqësuar nga Skënder Gjinushi e Teodor Laço.

OBJEKTI I KËRKESËS

Shfuqizimii ligjit nr.7593, datë 29.7.1992 "Për një riformulim të nenit 80 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", si ligj që vjen në kundërshtim me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Me ligjin nr.7593, datë 29.7.1992, është vendosur që neni 80 i ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" të riformulohet si vijon: "Numri i vendeve që i takojnë çdo subjekti elektoral caktohet në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ka fituar çdo subjekt. Shpërndarja bëhet duke i dhënë çdo subjekti një numër të plotë vendesh nëpërmjet rrumbullakosjes nga lart sipas radhës (duke u nisur nga shifra më e lartë pas presjes dhjetore).

Vendet e fituara u jepen kandidatëve në bazë të renditjes që kanë në listat e paraqitura nga subjektet elektorale".

Gjithashtu, me këtë ligj është shfuqizuar paragrafi i dytë i nenit 1 të dekretit nr.267, datë 22.7.1992 "Për një shtesë në ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" me këtë përmbajtje: "Shpërndarja e vendeve përcaktohet sipas formulës së bashkëngjitur".

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste me shkresën datë 1.8.1992 dërguar kësaj Gjykate ka kërkuar: "që të mos aprovohet ndryshimi i ligjit elektoral" si antikushtetues.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, përfaqësuesit e anës kërkuese saktësuan, se nuk e quajnë antikushtetuese vetë përmbajtjen e ligjit nr.7593, datë 29.7.1992, por kërkojnë që të mos zbatohet ky ligj për zgjedhjet e 26 korrikut 1992.

Sipas nenit 30 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i vetmi organ kompetent i ngarkuar për zbatimin e dispozitave ligjore për zgjedhjet.

Gjithashtu, sipas nenit 40 të po këtij ligji, kundër vendimit të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve mund të bëhet ankim nga subjektet e interesuara në Gjykatën e Kasacionit.

Në këto rrethana, gjykata çmon, se kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste është e pabazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Në zbatim të neneve 17 e vijuesa të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese,

VENDOSI

Rrëzimin e kërkesës.

Heqjen e pezullimit për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prere.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në "Fletoren Zyrtare".

Tiranë, më 7.8.1992